

4.

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Zemë e Kosovës / Vlada / Vlada / Government of Kosovo Ministria e Ekonomisë / Министрство Економског Развоја / Ministry of Economic Development	
Numri i Dregimit / Broj Licenciranja / No. Licenzierung: NJMNP	Numri i Postës / Broj Pošte / Post. No: 1671
Numri i Foliosës / Broj Listine / List. No: 10	Data e Dregimit / Datum Licenziranja / Date of Licensing: 28-09-11
PRISHTINE/A	

ANKESË

DREJTUAR: 1. Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

Nga : Abdullah Haxhiu *Abdullah* 044/626799

LËNDA PËR SHQYRTIM: Kundërshtim në përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës.

PËRMBLEDHJE: Unë, si njëri nga kandidatet për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK,po ju parashtoj ankesë ndaj vendimit të Bordit të Drejtorëve të KMDK-ës, i cili me datë 22.09.2011 ka mbajtur intervestimin me kandidatëve të selektuar, qe kan aplikuar ne konkursin e shpallur publik të datës 04.Korrik.2011, për Poziten e Kryeshefit Ekzekutiv(KE) te KMDK

Bordit të Drejtorëve te KMDK-ës nga kandidatet e selektuar dhe të intervistuar ka përzgjedhur kandidatin z.Hamdi Aliu. Me këtë rast Bordi i Drejtorëve te KMDK-ës, ka bërë shkelje dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Republikës së Kosovës dhe atë të Ligjit nr.03/I-087 për Ndërmarrjet Publike.

Nuk është respektuar komplet neni 21 sidomos paragrafi 21.3 dhe 21.4 ku kerkohet decidivishtë respektimi i nenit 17 paragrafi 17.1 dhe paragrafi 17.2 pikat (d),(f),(j),(k) dhe (l). Ku ne nenin 17.2, pika k , decidivisht thuhet se nje person nuk zgjidhet nese : k) është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajsh para datës së aplikimit ka qenë (i)zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike;

Kandidati i përzgjedhur z.Hamdi Aliu në periudhën 36 muajshe e deri ne ditën e intervistimit, ka ushtruar poste politike ne Komunën e Shtërpcës ,deri ne vitin 2010 ka qen nenkryetar komune ne Shterpcë, dhe është anetar i Kuvendit Komunal(deputet i asambles dhe zevendes kryesues) nga Partia Demokratike e Kosoves e që është në kundërshtim me ligjin per ndermarrjet publike.

Bordi i Drejtorëve te KMDK dhe kandidati, me vetëdije apo pa te, nuk e kan zbatuar ligjin dhe kan ra ne kundershtrim edhe me politkat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për respektimin e ligjshmëris dhe të transparencës.

Si dëshmi për mos respektim te ligjshmërisë i bashkangjes disa të dhëna të tjera argumentuese te cilat janë të përfshira në këtë ankesë.

Besoj qe, kjo shkelje e Ligjit mbi Ndermarrjet Publike nga ana e Bordit dhe Kandidatit është bërë në munges të njohurive dhe se Njesia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike(NJMNP) do të bëjë interpretimin e duhur të ligjit dhe të procedurave,nuk do të lejoj shkeljen e tijë, dhe se NJMNP Do t'i sygjeroj Bordit të Dretorëve KMDK-ës, që në afatin sa me të shkurtër kohorë, të veprojnë konform ligjit dhe të përmirsojnë shkeljen që ka bërë , në të kundërtën unë jam i detyruar që pa vullnetin tim të ju drejtohem edhe instancave tjera. Të drejtën time do ta kërkoj tek Auditorit Gjeneral,Agjensioni Anti Korrupsion edhe në Gjykatë , do të kërkoj që shkelsit e ligjit të ndeshkohen për mos respektim të ligjshmërisë,në veqanti për shkeljen e ligjit për ndermarrjet publike neni 21. dhe nenit 17.

PARASHTRUESI I ANKESËS :Abdullah Haxhiu- Kandidatë i intervistuar për Pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv te KMDK-ës

Abdullah

Datë 27.09.2011 Prishtinë